

SHTOJCA 1 – Qëllime dhe kriteret

Në përputhje me thirrjen publike për grumbullimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2023, të dedikuara për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2023, Qyteti i Shkupit, përcaktoi qëllimet dhe kriteret e mëposhtme:

I

Qëllime të përgjithshme që vlejné për të gjitha fushat e theksuara në Thirrjen publike:

- zhvillimi dhe avancimi i veprimtarive kulturore nga fusha e kulturës në territorin e qytetit të Shkupit;
- ruajtja dhe afirmimi i trashëgimisë materiale, shpirtërore dhe kulturore të qytetit të Shkupit;
- inkurajimi dhe afirmimi i diversitetit kulturor të pjesëtarëve të bashkësive etnike në qytetin e Shkupit;
- akses në të mirat dhe vlerat kulturore për qytetarët;
- risi, mbresa dhe origjinalitet i idesë;
- vazhdimësia e manifestimeve tradicionale kulturore dhe artistike që janë me interes për qytetin e Shkupit;
- prezantimi dhe afirmimi i krijimtarisë bashkëkohore, kulturës urbane dhe artit publik;
- stimulimi i medieve të reja dhe hulumtimeve në kulturë;
- afirmimi dhe mbështetja e artistëve dhe autorëve të rinj (deri në 35 vjeç),
- zhvillimi i kulturës rinore në kuadrin e së cilës do të mbështeten projekte kreative dhe edukative nga kategoritë e artit skenik, artit pamor, artit të medieve të reja dhe letërsisë dhe librit/strip, album/novelë grafike);
- zhvillimi i skenës kulturore të pavarur profesionale;
- zhvillimi i kulturës amatore në kuadër të së cilës do të mbështeten projekte kreative dhe edukative nga kategoritë e artit skenik, arteve vizuale, arkitekturës dhe dizajnit, artit dhe letërsisë së medieve të reja (libër/strip album/novelë grafike);
- mbështetja dhe zhvillimi i vlerave tradicionale kulturore;
- krijimi i bashkëpunimit dhe partneritetit në kuadër të projektit të propozuar me një ose më shumë institucione publike nga fusha e kulturës së Qytetit të Shkupit, institucionet kombëtare, organizatat e shoqërisë civile, komunat e qytetit të Shkupit, institucionet arsimore dhe organizatat e tjera;
- përkujtimi i ngjarjeve jubilarë dhe datave të rëndësishme;
- projekte që synojnë zhvillimin dhe promovimin e fushave të industrive kulturore dhe kreative;
- organizimi i festivaleve ndërkombëtare që mbahen në Shkup;
- stimulimi dhe mbështetja e projekteve të ndryshme partnere ndërkombëtare;
- nxitja e mendimit shkencor dhe kritik nëpërmjet organizimit të seminareve, konferencave dhe debateve;
- realizimi i punësive edukative për fëmijët dhe të rinjtë, si dhe për stafin mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme, me qëllim nxitjen e krijimtarisë së tyre dhe përmirësimin e zhvillimit kulturor të fëmijëve dhe të rinjve.

II

Qëllime specifike për fushat e përcaktuara në thirrjen publike:

1) Qëllime të veçanta në fushën e veprimtarisë muzeore dhe promovimit të trashëgimisë kulturore:

prezantimi, popullarizimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike në qytetin e Shkupit;

- përdorimi i trashëgimisë kulturore si burim për zhvillimin e turizmit;
- organizimi i fushatave, punëtorive dhe ligjëratave për promovimin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore në territorin e qytetit të Shkupit.

2) Qëllime të veçanta në fushën e veprimtarisë botuese dhe bibliotekare:

- botimi i librave dhe edicioneve elektronike, botimeve, monografive, antologjive që trajtojnë tema të jetës bashkëkohore dhe të historisë së Shkupit;
- mbështetje e krijimtarisë letrare me vlera të larta nga autorë që krijojnë në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët e komuniteteve në qytetin e Shkupit;
- vepra me vlera të jashtëzakonshme kulturore, monografi, botime profesionale, si dhe vepra që janë rezultat i projekteve hulumtuese për qytetin e Shkupit;
- botime të dedikuara për fëmijët dhe të rinjtë;
- për vepra të autorëve me botim të parë janë të detyrueshme dy (2) recensione dhe
për vepra të autorëve me disa vepra letrare të botuara është i detyrueshëm një (1) recension

3) Qëllime të veçanta në fushën e arteve vizuale dhe artit të medimeve të reja:

- ekspozita monografike-retrospektive me rëndësi të veçantë për qytetin e Shkupit që pasqyrojnë vazhdimësinë e veprimtarisë artistike në Shkup të konfirmuara nga kritika e artit dhe historia e artit;
- projekte të pavarura, grupe dhe të tjera nga vendi dhe jashtë vendit që promovojnë format dhe shprehjet artistike bashkëkohore dhe kontribuojnë në zhvillimin e gjuhës artistike bashkëkohore në qytetin e Shkupit;
- promovimi dhe zhvillimi i artit bashkëkohor urban me theks në shfrytëzimin e hapësirave publike të qytetit si dhe hapësirave të tjera alternative për prezantimin e veprave të artit në qytetin e Shkupit;
- mbështetja e festivaleve të filmit;
- projekte ekspozite në fushën e industrive krijuese; dhe
- ekspozita dhe projekte të artistëve të rinj në fushën e arteve vizuale dhe artit të medieve të reja (deri në 35 vjeç).

4) Qëllime të veçanta në fushën e artit skenik:

- kultivimi dhe prezantimi i krijimtarisë kombëtare dramatike dhe muzikore-skenike të stileve dhe zhanreve të ndryshme artistike me përfaqësimin e autorëve tradicionalë dhe bashkëkohorë;
- prezantimi i veprave më të mira artistike nga dramaturgjia botërore në Shkup, si dhe veprave nga fusha e artit muzikor dhe skenik,

- punëtori me të rinjtë si dhe me persona me nevoja të veçanta në fushën e arteve dramatike dhe muzikore-skenike;
- mbështetja e festivaleve teatrore;
- prezantimi i folklorit maqedonas dhe i folklorit të pjesëtarëve të komuniteteve që jetojnë në qytetin e Shkupit; dhe
- prezantimi i folklorit maqedonas dhe i folklorit të pjesëtarëve të komuniteteve që jetojnë në qytetin e Shkupit në festivale dhe manifestime që mbahen në qytete të vendeve të tjera me të cilat qyteti i Shkupit ka bashkëpunim, gjë për të cilat duhet të depozitohet ftesë nga organizatori i manifestimit.

5) Qëllime të veçanta në fushën e arteve muzikore:

- promovimi dhe interpretimi i veprave dhe krijimtarisë muzikore me shumëllojshmëri stilistike dhe zhanresh;
- nxitja dhe interpretimi i formave dhe shprehjeve të reja muzikore;
- mbështetja e festivaleve muzikore,
- stimulimi i krijimtarisë muzikore maqedonase dhe krijimtarisë muzikore të komuniteteve që jetojnë në qytetin e Shkupit me vlera të larta artistike; dhe
- mbështetje për koncertet e muzikantëve të rinj - interpretues dhe kompozitorë.

6) Qëllimet e veçanta në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar:

- bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në manifestime ndërkombëtare, festivale dhe projekte të bazuara në reciprocitet, për të cilat duhet të depozitohet një ftesë nga organizatori;
- programe dhe projekte në fushën e kulturës që do të zhvillohen në territorin e qytetit të Shkupit dhe të cilat kanë siguruar mbështetje financiare (grant) nga fondet e Komisionit Evropian, UNESCO-s dhe/ose fondeve të tjera ndërkombëtare; dhe
- bashkëpunimi dhe zbatimi i projekteve të përbashkëta me organizata, institucione dhe individë nga:
 - a) qytete të binjakëzuara me Qytetin e Shkupit
 - b) qytete me të cilat është vendosur protokoll ose program bashkëpunimi dhe
 - c) qytete që bashkëpunojnë me Qytetin e Shkupit në bazë të kontakteve të vendosura (<https://skopje.gov.mk/>) – link i portalit zyrtar të Qytetit të Shkupit.

III

Përzgjedhja e programeve dhe projekteve do të bëhet mbi bazën e kriterëve të shprehura në pikë si më poshtë:

1. Veprimtari profesionale në kulturë

Kritere për veprimtari profesionale në kulturë	Pikë
1. Struktura dhe resurse të organizatës	25
1.1 Eksperiencë e aplikuesit në zbatimin dhe realizimin e projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës	10
1.2 Profesionalizmi i personave të cilët marrin pjesë në zbatimin e projektit dhe aktivitetit	10
1.3 Dukshmëria e organizatës (online)	5
2. Buxheti i projektit:	25
2.1 Plan i hollësishëm financiar i përgatitur për mjetet e nevojshme për realizimin e programit/projektit	10
2.2. Arsyetimi i shpenzimeve në planin financiar të propozuar (buxheti real në lidhje me aktivitetet dhe numrin e personave të angazhuar, përshkrimi i shpenzimeve sipas pozicioneve dhe sa janë ato adekuate me çmimet e tregut).	10
2.3 Mjete plotësuese të siguruara nga burime vetjake ose të tjera.	5
3. Cilësia e programit/projektit:	50
3.1 Aktivitete programore të përgatitura në mënyrë të hollësishme nga programi /projekti dhe aplikim i plotësuar në mënyrë të rregullt në përputhje me rregullat e thirrjes publike	10
3.2 Kontributi i programit/projektit në realizimin e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta për zhvillimin e kulturës në nivel të Qytetit të Shkupit	20
3.3 Zgjidhje cilësore dhe inovative të ofruara për realizimin e qëllimeve projektuese të cilat përmbajnë inovacion, mbresa dhe origjinalitet të ideve.	10
3.4 Përkrahje institucionale e siguruar (ftesa nga festivale, shkresë me përkrahje nga institucion tjetër kulturor ose organ kompetent, përfshirje e një ose më shumë subjekteve në realizimin e programit /projektit)	10
Pikë gjithsej:	100

2. Veprimtari rinore në kulturë

Kritere për veprimtari rinore në kulturë	pikë
1. Cilësia e aplikuesit	20
1.1 Eksperienca e aplikuesit në realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e veprimtarisë rinore në kulturë	10
1.2 Lista me referenca (rekomandime, mirënjohje dhe shpërblime, pjesëmarrje të mëparshme të manifestimeve etj.)	10
2. Buxheti i projektit	20
2.1 Plan i hollësishëm financiar i përgatitur për mjetet e nevojshme për realizimin e programit-projektit	10
2.2. Arsyetimi i shpenzimeve në planin financiar të propozuar (buxheti real në lidhje me aktivitetet dhe numrin e personave të angazhuar, përshkrimi i shpenzimeve sipas pozicioneve dhe sa janë ato adekuate me çmimet e tregut).	5
2.3 Mjete plotësuese të siguruar nga burime vetjake ose të tjera.	5
3. Cilësia e programit/projektit:	40
3.1 Aktivitete programore të përgatitura në mënyrë të hollësishme nga programi /projekti dhe fletëparaqitje e plotësuar në mënyrë të rregullt (aplikimi).	10
3.2 Zgjidhje kualitative dhe inovative të ofruara për realizimin e qëllimeve projektuese të cilat përmbajnë inovacione, mbresa dhe origjinalitet të ideve	10
3.3 Kontributi i programit/projektit në realizimin e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta për zhvillimin e kulturës në nivel të Qytetit të Shkupit	10
3.4 Kontributi i projektit në realizimin e pjesëmarrjes rinore në kulturë	10
4. Profili i pjesëmarrësve	20
4.1 Numri i të rinjve të përfshirë direkt në projekt (artistë deri në moshën 35 vjeç, të rinj deri në moshën 30 vjeç)	10
4.2. Përkrahje institucionale e siguruar (ftesa nga festivale, shkresë me përkrahje nga institucion tjetër kulturor ose organ kompetent, përfshirje e një ose më shumë subjekteve në realizimin e programit /projektit)	5
4.3 Numri i vlerësuar i të rinjve (deri në moshën 30 vjeç) me të cilët ka të bëjë projekti (publiku i parashikuar, përfitues direkt dhe indirekt)	5
Pikë gjithsej:	100

3. Veprimtari amatore në kulturë

Kritere për veprimtari amatore në kulturë	pikë
1. Program/Projekt:	25
1.1 Program/projekt i përpunuar në mënyrë të detajuar në përputhje me rregullat e konkursit dhe aplikacion i plotësuar në mënyrë të rregullt në përputhje me rregullat e Thirrjes publike	20
1.2 Përvoja e aplikuesit në realizimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve në fushën e kulturës	5
2. Buxheti i programit/projektit:	25
2.1 Plan financiar i përgatitur në mënyrë të detajuar në lidhje me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e programit/projektit	10
2.2. Arsyetimi i shpenzimeve në planin e propozuar financiar (buxhet real në raport me aktivitetet dhe numrin e personave të angazhuar, përshkrim i shpenzimeve sipas pozitave dhe sa ato përputhen me çmimet e tregut)	10
2.3 Sigurimi i mjeteve plotësuese nga burime individuale ose burime tjera	5
3. Cilësia e programit/projektit:	50
3.1 Kontributi i programit/projektit në realizimin e qëllimeve të përgjithshme dhe të veçanta për zhvillim të kulturës në nivel të Qytetit të Shkupit	20
3.2. Inovacion, mbresa dhe origjinalitet i idesë	20
3.3 Sigurim i përkrahjes institucionale (ftesa nga festivale, letra për përkrahje nga institucion tjetër kulturor ose organ kompetent, përfshirje e një ose më shumë subjekteve në realizim e programit/projektit)	10
Pikë gjithsej:	100

IV

Gjatë alokimit të mjeteve të parashikuara në Programin për financimin e institucioneve publike dhe aktiviteteve kulturore me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2023, do të merren parasysh aktivitetet, projektet dhe manifestimet të cilat në përputhje me kriteret do të sigurojnë së paku 60 pikë.